



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MULI Y. MALLKUÇI
ADRESA NR.5, VASO PASHA, NR.13/1
TEL: 692020292

REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

Nr. repertori: 812

Nr. koleksioni: 499

Tirane më 04/09/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 6 fletë



A2025050370054040275



A2025050370054040275



AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"G&P Development SH.P.K"

Sot, më datë 04.09.2025, para meje Noter MULI Y. MALLKUÇI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, VASO PASHA, NR.13/1, u paraqit personalisht:

THEMELUES:

Petrit Katorri, atësia Glenard, amësia Irilda, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Gjon Buzuku Nr84; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 8; Njesia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 20/04/1998, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 039933432 dhe nr. personal J80420062D.

Ne cilesine e "Ortakut Themelues", redaktoj kete Akti Themelimi & Statut, nepermjet te cilit deklaroj se, me vullnet të lire, të plote e të singerte dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne Ligjin nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne Ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijoj shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, "G&P Development" sh.p.k., Tirane.

Neni 1

Krijimi

Shoqeria "G&P Development" sh.p.k., Tirane, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "G&P Development" shpk, Tirane, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakut i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne: Rr. "Gjon Buzuku", pallati nr. 84, Tirane.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesije, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.



Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Studimin, projektimin, konsulencën, sipermarrjen zbatuese dhe /ose investimin, për realizimin me fonde publike dhe/ ose jopublike të veprave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi publik dhe/ose privat si : ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve, nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, digave dhe veprave bonifikuese e ujore, ujesjellesave, linjave mbitokesore dhe nentokesore për energji dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe reabilitimin e veprave ujtesore, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet objektet industriale, të gjitha restaurimet në përgjithësi, rikonstruksione të veprave të artit etj. Tregtimin dhe import-eksportin e mallrave të ndryshëm si industriale e artikujve të ndryshëm, elektrike, mekanike, elektronike. Montimi e prodhimi i elementeve të pajisjeve të ndryshme. Aktivitet në fushën e turizmit. Aktivitet në fushën e transportit, shoqëria do të kryejë: Studimin, projektimin, konsulencën, sipermarrjen zbatuese dhe /ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ ose jopublike të infrastruktures dhe /ose të pjesëve përberëse të saj, për transportimin publik dhe /ose privat të njerezve dhe mallrave brenda dhe jashtë territorit të vendit si dhe tranzitimin e tyre përgjatë territorit të Shqipërisë nëpërmjet transportit rrugor, hekurudhor, ajror, ujor, teleferik etj. Kryerja e shërbimit E-Commerce, shitje online të produkteve dhe shërbimeve të shoqërisë G&P Development shpk. Shoqëria G&P Development Shpk mund të kryejë veprimtari ekonomike në fushë e real estate. Negocime, ndërmjetësime, përfaqësime të të tretave në fushën e real estate si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Shitje, blerje, dhenie me qira të të gjitha llojeve të pasurive të paluajtshme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe (do transaksion tjetër në funksion të përmbushjes së objektit të veprimtarisë në fushë e real estate. Shoqëria G&P Development Shpk mund të kryejë menaxhimin, blerjen, shitjen, dhenien me qira të pronave të paluajtshme si edhe ndërmjetësimi për shitje blerje apo dhenie me qira të pronave të paluajtshme midis personave fizike, personave juridike private dhe publike si dhe nga shteti si dhe (do veprim tjetër i ligjshëm që ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme. Kryerja e Shërbimit Real-Estate. Kryerja e shërbimit bar-kafe, restorant. Kryerja e shërbimit hotelier turizmit. Kryerja e shërbimit agjenci turistike.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të përcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000.000 Lekë dhe është i ndarë në 1 (kuote) pjesë, vlera nominale e të ciles është 1.000.000 Lekë.

Kapitali i mesipër është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakët i vetëm i shoqërisë, Z. Petrit Katorri, i cili zotëron 1 (një) të kuote, me vlerë të përgjithshme 1.000.000 Leke, që përbejnë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrajt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.



Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për keto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Ortakut të Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Ortakut të Vetem të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 5 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjetër. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakut të Vetem, ato mund të transferohen (tjetërsohen) me Kontrate Shitje dhe me Kontrate Dhurimi.

Neni 9

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Ortaku i Vetem është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ortaku i Vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët,

Ai mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person.

Neni 10

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortaku i vetem.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 11

Administrimi

Administrator i shoqërisë do të jetë Z. Petrit Katorri, për një afat prej 5 vjetesh.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetem të shoqërisë.

Neni 12



Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfarëdo formë qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 13

Pergjegjesite

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga ortakut i vetëm që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakut ka të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Ortakut ka të drejtë të ndjeke në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Ortakut që nuk është administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut të Vetëm, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut të Vetëm vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 16

Ekspertet



A2025050370054040275

Ekspteri ka per detyrë qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Ne perfundim të kontrollit ekspteri kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Neni 17

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortaku i vetem, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

Neni 18

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakut te vetem të shoqerise.

Neni 19

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene :

Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji “ Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare”

c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Neni 20

Bashkimi dhe ndarja

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortaku i vetem i shoqërise, që bën kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj t e shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.



A2025050370054040275

Neni 21

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar ne QKR.

Neni 22

Likuidatori eshte i detyruar që të jete i vemendshem dhe korekt, si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cileve shoqeria eshte kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve debive që shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqeria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këte statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këte statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit për QKR, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 24

Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25

Dispozita përfundimtare

Ky Akt Themelimi & Statut, u redaktua në 3 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nën nën nga një Ortaku themelues i shoqërisë tregtare “G&P Development” sh.p.k, ” Tiranë.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Unë Noteri verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

THEMELUES

Petrit Katorri

PETRIT KATORRI



NOTER

MULI Y. MALLKUÇI